

KONKURS PLOTËSUES-AFATI I TRETË(III-të) PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022



KONKURS PLOTËSUES-AFATI I TRETË(III-të) PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022

Senati i Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të statutit në mbledhjen e mbajtur më: ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2021/22, dhe ka miratuar kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore - Bachelor.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, në vitin e parë të studimeve, në afatin e tretë plotësues të konkursit për vitin akademik 2021/2022, do të regjistroj **452** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1,

bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri **84** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpëmdahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.

3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen deri në 3% përkatësisht deri **23** kandidatë të cilët kanë lindur në vendet jashtë Kosovës (Shtetas të Huaj dhe nga Trojet Shqiptare), ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përgjatimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren rezervon të drejtën e pranimin të kandidatëve me nevoja të veçanta.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren kanë të gjithë kandidatët shtetas kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Në Universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës.
10. Dëshmia për njohjen dhe barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ndërsa barasvlerën e notave do të bëhet nga Zyra për Çështje Akadematike, e cila gjendet në Administratën Qendrore kati II nr. 527. Sipas vendimit të Senatit me nr. 01-268 me datë , kandidatët të cilët pranohen duhet të sjellin dëshmitë (vendimin e nostrifikimit nga MASHTI) në një afat optimal në koordinim me Zyrën e Shërbimit Studentor, në të kundërtën do të bëhet ç' regjistrimi i tyre në përputhje me këtë vendim.

11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi (psh. në programet e Fakultetit të Filologjisë).
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në Universitet pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. Kandidatët për pranim si student të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren në vitin akademik 2021/22 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
2. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

1. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin

e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe,
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
1. Provimi pranues hartohet me 100 Pikë (ku sistemi sipas aplikuesit i konverton në 70 apo 40 pikë).
 2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijmë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
 3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të plotësuara sipas konkursit.
 4. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues, vendet e lira të cilat mbesin nga pika 2 dhe 3 nuk zëvendësohen.
 5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
 6. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës së mesme.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. **Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit, bëhet prej deri më , nga ora 09:00-15:00 (duke përfshirë edhe të shtunën) ditën e fundit dokumentet pranohen deri në ora 16:00. Provimi pranues do të mbahet më , duke filluar prej orës 09:00 (shih tabelën me orarin e mbajtjes së provimit pranues).**
2. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç'regjistrim nga fakulteti.
3. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:
4. Ekstraktin e lindjes (origjinale) jo me i vjetër se 6 muaj,
5. Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë),
6. Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme dhe dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),
7. Kopjen e letërnjoftimit,
8. Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është:
9. j) Kandidatët me rastin e aplikimit, bazuar në UA 09/2021 lirohen nga pagesa e provimit pranues.
10. g) Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. Dëshmia për njohjen dhe barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ndërsa barasvlerën e notave do të bëhet nga Zyra për Çështje Akadematike, e cila gjendet në Administratën Qendrore kati II nr. 527. kandidatët të cilët pranohen duhet të sjellin dëshmitë (vendimin e nostrifikimit nga MASHTI) në një afat optimal në koordinim me Zyrën e Shërbimit Studentor, në të kundërtën do të bëhet ç'regjistrimi i tyre në përputhje me këtë vendim.
11. Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 të këtij neni t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve.
12. **Çdo student që hyn në Universitet duhet të posedoj njëërën nga dëshmitë, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 01/35 të datës , për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19:**
 - Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19;

- Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
- Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave setrologjik -IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
- Test i shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.

6. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

Orari i mbajtjes së provimit pranues është:

Më :

Nr.	Data	Fakulteti	Programi	Prej	Deri	Grupi
1		Juridik	Juridik	9:00	10:30	RR
2		Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	9:00	10:30	RR
3		Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	9:00	10:30	RR
4		FSHK	Dizajn Softueri	9:00	10:30	RR
5		FSHK	TIT	9:00	10:30	RR
6		FSHK	TIT -Tur.	9:00	10:30	RR
7		Edukim	Program Fillor - Bos dhe Tur.	9:00	10:30	RR
8		Edukim	Prog. Parafillor- Bos dhe Tur.	9:00	10:30	RR
9		FSHJM	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisi	9:00	10:30	RR
10		FSHJM	Agrobiznes	9:00	10:30	RR

Shpallja e rezultateve preliminare do të bëhet më në ora 13:00 në faqen zyrtare të Universitetit.

Afati për ankesa është më: ndërsa shqyrtimi i tyre do të bëhet më duke filluar nga ora 09:00.

Ndërsa shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më së largu me datë më së largu ora 12:00

Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar do të bëhet me datën: prej orës 13:00 (shih tabelën e mëposhtme).

Kandidatët të cilët nuk arrinjë të regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbin mundësinë e regjistrimit, andaj ju lutemi që t'i përmbaheni afateve të caktuara.

Nr.	Fakulteti	Departamenti	Data e fotografimit	Ora
1	Juridik	Juridik		13:00 deri 18:00
2	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar		13:00 deri 18:00
3	FSHK	T I T (Shq. .)		13:00 deri 18:00
		S D		13:00 deri 18:00
4	Edukim	Fillor (Tur. Bos.)		13:00 deri 18:00
		Parashkollor (Tur. Bos.)		13:00 deri 18:00
5	Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Angleze		13:00 deri 18:00
6	FSHJM	Agrobiznes		13:00 deri 18:00
		Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit		13:00 deri 18:00

Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit duhet të paraqesin:

1.Fletëregjistrimin e plotësuar i cili merret me rastin e regjistrimit;

2.Një fotografi (formati 4.5 x 6 cm) të cilat duhet të bëhen nga fotograf profesionist;

3. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, vitin e parë të studimeve e kanë falas;

4. Pagesa për një semestër për studentët e rregullt që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, është në shumën prej 25€.

Bazuar në UA 09/2021, kandidatët e pranuar lirohen nga pagesa për regjistrim të semestrave për herën e parë.

Për informata më të hollësishme kandidatët duhet ta vizitojnë ueb faqen zyrtare:

1. Numri i studentëve të cilët do të pranohen në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren - sipas programeve është si në tabelën:

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Për studi. të rregullta	Për komunitete 12%	Kandidatet nga jasht RKS-së 3%	Total
1	Fakulteti Juridik	Juridik	0	10	1	11
2	Fakulteti Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	72	21	5	98
3	Fakulteti Ekonomik	Administrim Biznesi	0	0	0	0
4	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor	0	0	0	0
5	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor	0	0	0	0
6	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor- Bos.	12	0	1	13
7	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor- Bos.	16	0	0	16
8	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor- Tur.	11	0	0	11
9	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor- Tur.	8	0	0	8
10	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	TIT	88	19	5	112

11	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	SD	53	19	5	77
12	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	TIT- Bos.	0	0	0	0
13	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	TIT- Tur.	19	0	0	19
14	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	0	0	0	0
15	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	0	3	3	6
16	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	0	0	0	0
17	të Jetës dhe Mjedisit	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	25	5	1	31
18	të Jetës dhe Mjedisit	Agrobiznes	41	7	2	50

Sqarim: Në tabelën e paraqitur me kuota për nxënësit që kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake, do të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesa dhe diploma.

Përrjashtim nga vërejtja e lartpërmendur përbëjnë kandidatët të cilët vijnë nga komunat në të cilat nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë. Këta kandidatë duhet ta plotësojnë formularin për vetdeklarim lidhur me përkatësinë e tyre etnike.

LËNDËT NË PROVIM PRANUES:

Juridik: Fillet e së Drejtës, E drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.

Menaxhment Ndërkombëtar: Hyrje në Ekonomi, Matematikë

Gjuhë dhe Letërsi Angleze: Gjuhë dhe Letërsi Angleze

TIT dhe DS: Kompjuterikë (programim, baza e të dhënave, rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë.

5.Programi Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit: Matematikë, Kimi dhe Biologji.

6.Programi Agrobiznesit:Hyrje në Shkencat e Natyrës, Hyrje në Ekonomi dhe Matematikë.

Në Gjuhën Boshnjake:

Fillor: Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.

Parashkollor: Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.

Në Gjuhën Turke:

Fillor: Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.

Parashkollor: Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.